

VENDIM
Nr. 393, datë 20.3.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
KORÇË QAFË-PLLOÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë Qafë-Plloçë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë arë 12 493 m², me vlerë 4 263 403.3 (katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e tre pikë tre) lekë, truall me sipërfaqe 543 m², me vlerë 1 336 985 (një milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, kultura bujqësore dhe drufrutorë, me vlerë 5 535 033.3 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tridhjetë e tre pikë tre) lekë, objekt me vlerë 1 576 219 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 12 711 640.6 (dymbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet pikë gjashtë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 8 260 000 (tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera totale e shpronësimit, prej 12 711 640.6 (dymbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet pikë gjashtë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas listave bashkëlidhur, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë e Pogradec, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë dhe Pogradec, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë dhe Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha